



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë: 17.09.2021

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “SI.SI-AL sh.p.k” shpk me NUIS K72117030P, me adresë: Autostrada Tirane-Durres, Km 4, Perballe BMV-se, Kashar, Tiranë.

Procedura e prokurimit/lotit: E hapur

Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-04077-08-30-2021

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Materiale për sinjalistikë (Birila, grerëza, kangjella)”, me afat lëvrimi brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës, fond limit 11.574.650 (njëmbëdhjetë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 132, datë 07.09.2021.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “SI.SI-AL sh.p.k” shpk me NUIS K72117030P, me ofertë ekonomike 10.772.800 (dhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e tetëqind) lekë pa tvsh.
2. Operatori ekonomik “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” shpk me NUIS K82230002K, me ofertë ekonomike 11.458.800 (njëmbëdhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) lekë pa tvsh.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “ERAL CONSTRUCTION COMPANY” shpk me NUIS K82230002K.

Për arsyet e mëposhtme

- Nuk përmbush pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se “Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar për mallrat,

objekt prokurimi. Në rast se paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja ndërmjet distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.” pasi operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e kësaj pike.

- Nuk përmbush pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se “*Për mallrat objekt prokurimi, katalogun dhe/ose skadat teknike të botuara nën autoritetin e prodhuesit, që nënkupton se duhet të jenë me logon e tij dhe ku jepen të gjitha karakteristikat teknike të këtyre materialeve me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.*” pasi operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e kësaj pike.
- Nuk përmbush pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se “*Në orën e përcaktuar për hapjen e ofertave, tek Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, nga 1 (një) mostër për të gjithë mallrat objekt prokurimi (referoju listës në shtojcën 6), nëpërmjet të cilave do të bëhet verifikimi i produktit. Mosparaqitja e mostrave përbën shkak për skualifikim.*” pasi operatori ekonomik nuk është paraqitur me mostrat e kërkuara sipas parashikimit të kësaj pike.* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë “SI.SI-AL sh.p.k” shpk me NUIS K72117030P, me adresë: Autostrada Tirane-Durres, Km 4, Perballe BMV-se, Kashar, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 10.772.800 (dhjetë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e tetëqind) lekë pa tvsh është **identifikuar si Oferte e suksesshme.**

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik’.